



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR PËCAKTIMIN E SASISË SË FONDIT PUBLIK QË PËRFITOJNË PARTITË POLITIKE PËR ZGJEDHJET E DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 27.07.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI-	Kryetar
Denar	BIBA-	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me

Objekt: Përcaktimi i sasisë së fondit publik që do t'u shpërndahet partive politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, në Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, të datës 30 qershor 2019, dhe që kanë fituar mbi 0.5% të votave të vlefshme.

Baza Ligjore: Neni 23, pika 1, gërma a, neni 87, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN



Nr.10098 i Vendimit Data 27.07.2019 e Vendimit Ora 12.00 e Vendimit

Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që përfitojnë partitë politike për zgjedhjet e datës 30 Qershor 2019

Kodi Zgjedhor në nenin 87, pika 1, përcakton se, partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 0.5 për qind të votave në shkallë vendi, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje.

Sipas vendimit të KQZ-së nr.10097, datë 27.07.2019 "Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 Qershor 2019", partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që kanë fituar jo më pak se 0.5 për qind të votave në shkallë vendi, janë:

1. Partia Socialiste e Shqiperise	74.11%
2. Partia Demokracia Sociale	3.66%
3. Partia Socialdemokrate e Shqiperise	3.60%
4. Partia Bindja Demokratike	2.67%
5. Partia e Gjelber	1.87%
6. Partia e Unitetit Kombetar	1.32%
7. Partia Aleanca Arbnore Kombetare	1.25%
8. Partia Socialiste e Moderuar	1.14%
9. Partia Fryma e Re Demokratike	1.13%
10. Partia Aleanca Demokristiane e Shqiperise	1.05%
11. Partia Aleanca Demokratike Shqiptare	0.87%
12. Partia Kristian Demokrate	0.68%
13. Partia Ardhmeria Shqiptare	0.66%
14. Partia G99	0.65%
15. Partia e Reformave Demokratike Shqiptare	0.61%
16. Partia Aleanca per Demokraci dhe Solidaritet	0.59%



Nr.10098 i Vendimit Data 27.07.2019 e Vendimit Ora 12.00 e Vendimit

Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që përfitojnë partitë politike për zgjedhjet e datës 30 Qershor 2019

Fondi i vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit për financimin e fushatës zgjedhore të partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 30 Qershor 2019, është **65,000,000** milionë lekë, i cili u pjestua me **734,579**, shifër kjo që korespondon me numrin e votave të vlefshme të grumbulluara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 30 Qershor 2019 dhe që kanë fituar jo më pak se 0.5 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi. Rezultati, 88 lekë është vlera e një vote të vlefshme.

Vlera 88 lekë u shumëzua rast pas rasti me numrin e votave të vlefshme të fituara nga secila parti që përfiton, pra që ka fituar jo më pak se 0.5 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi në zgjedhjet e datës 30 Qershor 2019, shifra që del është ajo që përfiton secila parti politike.

Nga kjo shumë zbritet fondi i dhënë paradhënie sipas përcaktimeve të nenit 87/3 të Kodit Zgjedhor. Nëse shuma e marrë paradhënie është më e madhe se llogaritja përfundimtare, partia duhet të kthejë fondet në buxhetin e shtetit, në rast të kundërt përfiton fonde shtesë nga buxheti i shtetit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 23, pika 1, gërma a, nenin 87, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e partive politike që përfitojnë fonde sipas rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 Qershor 2019, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë listën e partive politike që duhet të kthejnë fonde sipas rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30 Qershor 2019, sipas lidhjes 2, bashkëlidhur këtij vendimi.



Nr.10098 i Vendimit Data 27.07.2019 e Vendimit Ora 12.00 e Vendimit

Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që përfitojnë partitë politike për zgjedhjet e datës 30 Qershor 2019

3. Partitë politike të përcaktuara në lidhjen 2, bashkëlidhur këtij vendimi, të kthejnë fondet brenda 90 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI-	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr.10098 i Vendimit Data 27.07.2019 e Vendimit Ora 12.00 e Vendimit

Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që përfitojnë partitë politike për zgjedhjet e datës 30 Qershor 2019